



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUSHAJ
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1
Tirane
TEL: 0692097547

MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 1693

Nr. koleksioni: 720

Tirane më 03/04/2025

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 124/2024, datë 19/12/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2025000010008225444



MARREVESHJE SIGURUESE MBI KUOTAT E PJESEMARRJES NE SHOQERI

Ne Tirane, sot me date 03.04.2025 (dy mije e njezete e pese), perpara meje noteres M. Sodeshej, anetare e Dhomes Kombetare te Notereve, Dega 11 Hone, me adrese Rruga "Vaso Zasho" 7/13/11, u paraqiten personalisht palet::

BARREMARRES / KREDIDHENES:

RAIFFEISEN BANK SH.A., një bankë e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri, dhe regjistruar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr.17426, datë 10.07.1997, me NUIS.J61911005B, e përfaqësuar nga përfaqësuesit e saj ligjor Z. Christian Canacaris, i biri i Stavros, dtl.19.07.1966, lindur ne Paris, France dhe banues ne Tirane, i identifikuar me pashaporte nr. BA2574902 dhe nr. personal G60719130R, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe Znj. Gledisa Buxhuku, atesia Taulant, dtl. 11.05.1977, lindur ne Elbasan dhe banuese ne Tirane, identifikuar me pasaporten me nr. BR8753702 dhe numer personal H75511212O madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar (ketu e me poshte do te quhet Banka ose Barremarresi/Kredidhenes),

BARREDHENES:

Shoqeria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" shpk, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit datë regjistrimi 10/08/2022, me NUIS M22010013H, me seli ne Tirane, Ndërtesa "Park Gate", rruga e Elbasanit, kati i parë, Tiranë e perfaqesuar sipas Vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise nr. 1674 rep date 03/04/2025 nga Znj. Kristjana Zhamo, atesia Bardhul, dtl. 10.05.1993, lindur ne Permet dhe banuese ne Tirane, ne adresen rruga Aleksander Moisiu, Tirane identifikuar me pasaporten nr. BJ1234507 dhe me nr. personal J35510032J, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar (ketu e me poshte do te quhet (këtej e tutje referuar si Barredhenes)

BASHKEKREDIMARRRES:

Shoqeria "INFO-Telecom" SHPK, e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në QKB me NUIS nr. K92402002P, datë regjistrimi 02.12.2009, me seli ne Rruga "Faik Konica" nr. 1, Pallati Kuq perballe Fakultetit Ekonomik, Tirane, Shqiperi, e perfaqesuar sipas Vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise nr. 1676 rep date 03/04/2025 nga administratorja Znj. Ada Osmanaj, atesia Esref, dtl. 01.01.1982, lindur dhe banuese ne Tirane, ne adresen Mujo Ulqinaku, Njesia Bashkiake 10, identifikuar me leternjoftimin me nr. 038835010 dhe me nr. personal I25101422N, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar (ketu e me poshte do te quhet (këtej e tutje referuar Shoqeria/Bashkekredimarres)

Baza Ligjore

Kjo kontrate hartohet bazuar ne nenet 6, 24, 31, 420, 605, e ne vazhdim te Kodit Civil,

- Ligji Nr. 110/2018 "Per Noterine"

- Ligji nr.8537, date 18.10.1999 "Per barret siguruese" (i ndryshuar)

- Ligji nr. 9887, date 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e te dhenave personale";

Neni 1

INTERPRETIMI

1.1 PERKUFIZIME

Ne kete Marreveshje, termat dhe shprehjet qe vijojne do te kene kuptimet e meposhtme:

(a) "Kolateral" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 2.1 te kesaj marreveshjeje.

(b) "Detyrime" do te thote te gjitha detyrimet, pergjegjesite dhe borxhet e cfaredo natyre apo lloji te Barredhenesit ndaj Barremarresit (duke perfshire ketu interesin, tarifat ligjore dhe shpenzimet) qe ai i detyrohet kohe pas kohe, te tashme apo te ardhme, te sigurta apo te mundshme, te maturuara apo jo, te zgjeruara apo te rinovuara qofshin, te marra persiper ne cdo kohe dhe nga kushdo, dhe cdo balance perfundimtare te papaguar deri tani.

(c) "Borxhe te tjera" do te thote libra, dokumente,shkresa,letra,shenime dhe te dhena elektronike, si dhe te gjitha llogarite e tashme dhe te ardhme, borxhet, pretendimet, detyrimet ne para dhe kerkesat e cdo natyre dhe lloji pavaresisht nese jane te evidentuara nga instrumentet, te cilat jane kerkuar ose do te kerkohen, do te paguhen, detyrime keto te Barredhenesit dhe te gjitha te ardhurat prej tyre.

(d) "Kuota" ka kuptimin e kuotave te pjesemarrjes ne shoqeri dhe te drejtat e lidhura me to sipas legjislacionit ne fuqi

(e) "Detyrime te siguruar" ka kuptimin qe i eshte dhene ketij termi ne Nenin 3.1 si vijon

(f) Te Drejtat e Lidhura "do te thote:

- (i) çdo dividend ose interes i paguar ose i pagueshem ne lidhje me Kuotat;
- (ii) çdo kuote, letra me vlere, te drejta, te holla ose pasuri te lindura ose te ofruara ne çdo kohe (nese me ane te kthimit, bonus, preferimit, te drejtave me kusht, zevendesimin, kembimin ose ndryshe) ne lidhje me ose mbi cilendo nga Kuotat;
- (iii) te gjithë dividendë, interesat ose te ardhura te tjera ne lidhje me çdo aset te pemendur ne paragrafin (ii) me lart; dhe
- (iv) te gjithë te drejtat e votes ne lidhje me Kuotat, te cilat mund te ushtohen si ne asamblene e zakonshme, ashtu edhe ne asamblene e jashtezakonshme te Shoqerise.

Neni 2

BARRA SIGURUESE

2.1 KRIJIMI I BARRES SIGURUESE

Barredhenesi Shoqeria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" shpk eshte ortak i vetem i shoqerise Shoqeria "INFO-Telecom" shpk e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS M22010013H, datë 10/08/2022, me seli ne Ndërtesa "Park Gate", rruga e Elbasanit, kati i parë, Tiranë. Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar per te dhenat e Subjektit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar struktura e ortakeve te kesaj shoqerie paraqet si ortak te saj barredhenesin si me poshte vijon:

- "GJONAJ GROUP HOLDINGS" shpk – 100% te kuotave

Me ane te kesaj marreveshje siguruese Barredhenesit ketu i japin Barremarresit nje Barre Siguruese mbi kuotat, ne total 1 (nje) kuote me pjesemarrje 100% ne kapitalin e shoqerise "INFO-Telecom" shpk me te cilat sigurojne pagesen, permbushjen dhe shlyerjen e te gjitha detyrimeve te siguruara te Shoqerise "GreeNNat Solar Park Ballsh" shpk, ndaj Barremarresit.

Neni 3

DETYRIMET E SIGURUARA

3.1 DETYRIMET E SIGURUARA

Barra Siguruese qe jepet siguron pagimin dhe permbushjen e te gjithë detyrimet monetare (dhe detyrimet te cilat mund te vlersohen ne te holla) dhe detyrimet e Kredimarresit/Bashkekredimarresit kundrejt Kredidhenesit sve sipas Kontratave te Kredise me poshte , duke perfshire, por pa rene ne kundërshtim me parashikimet e pergjithshme parardhese, permbushjen e duhur te te gjithë detyrimeve per pagesat ne lidhje me kryegjene, interesat, kamat-vonesat, tarifat, kostot dhe shpenzimet, demet, taksa dhe taksat e pulles te pagueshme, çdo shume per sherbime ndërmjetesimi qe do te paguhen pas parapagimit ose ripagimit te te gjithë apo nje pjese te Kredise ne nje date tjeter nga data e caktuar per pagesen, dhe te gjitha e çdonjera prej kostove, shpenzimeve, takse pulle, taksat apo tarifat e pagueshme ne lidhje me mbrojtjen, ruajtjen apo ekzekutimin e detyrueshem te te drejtave te Kredidheneve sipas Kontrate Kredie Bankare nr. 1687 rep, nr. 714 kol, date 03/04/2025 (referuar ne kete marreveshje si Kontrate Kredie) dhe te gjithë detyrimet e Shoqerise dhe te Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje te lidhur ndërmjet Kredidhenesit dhe Kredimarresit/Bashkekredimarresit.

3.2 INTERESI I VAZHDUESHEM

Kjo Kontratë do të jetë gjithashtu e detyrueshme për barredhenesit edhe pas ndonjë ndryshimi, transferimi ose rinovimi të Kontratës së Kredisë ose të kësaj Kontrate. Barredhenesi në mënyrë të shprehur bie dakort për vazhdimësinë e kësaj Kontrate në rast të rinovimit të të gjithë ose të një pjese të Detyrimeve të Siguruara (duke përfshirë një rinovim të Kontratës së Kredisë)

3.3 APLIKIMI I PAGESAVE

Te gjitha parate e mbledhura apo te marra nga Barremarresit prej Barredhenesit do te shkojne per llogari te permbushjes se Detyrimeve ne menyren qe vete Barremarresit ka vendosur.

Neni 4

4.1 DETYRIME TE BARREDHENESIT

Barredhenesi detyrohet dhe garanton :

(a) te njoftoje Barremarresin menjehere per:

- cdo ndryshim te emrit te Barredhenesit;
- cdo ndryshim te vendit ku Barredhenesi zhvillon aktivitetin e tij tregtar ose, nese Barredhenesi ka me shume se nje vend te tille, te selise kryesore te Barredhenesit;
- cdo rast mospermbushjeje (sic eshte perkufizuar me poshte ne nenin 6);

(b) te autorizojë barremarresin te beje, ekzekutoje, njohe dhe shperndaje formularët e njoftimit te regjistrimit dhe kalime te metejshme te te dhe transfertave, dokumenteve, akteve, ceshtjeve dhe gjerave, duke perfshire shtojcat e metejshme te kesaj Marreveshjeje ne menyre qe kjo Marreveshje te kete efekt.

(c) Te paraqese miratimin nga Enti Rregullator i Energjise per vendosjes e kuotave te Barredhenesit si mjet per garantimin e permbushjes se detyrimeve, nepermjet vendosjes se barres siguruese mbi kuotat ne favor te Bankes, brenda nje afati 3 (mujor) nga data e nenshkrimt te kesaj Marreveshjeje Siguruese, sipas parashikimeve te Licences per prodhimin e energjise dhe Rregullores se ERE-s per Procedurat e Vendosjes se Kuotave te Ortakut si Mjete per Garantimin e Permbushjes se Detyrimit ndaj te Treteve.

(c) Barredhenesi bie dakort dhe pranon qe ne rast mospermbushjeje barremarresit ka te drejte te kryerje ekzekutimine detyrueshem te barreve sigures ne perputhje me Ligji "Per barret siguruese" dhe Barredhenesi nuk do te kerkoje procedure te ndryshme ekzekutimi nga ajo e parashikuar ne ligj duke hequr dore nga e drejta per ushtrim te Nenit 32 te ketij ligji.

4.2 SHPENZIMET

Barredhenesi duhet t'i paguaje Barremarresit, sipas kerkeses se gjitha kostot e arsyeshme te Barremarresit, taksat dhe shpenzimet duke perfshire, pa perjashtim, pagesat ligjore ne lidhje me pregatitjen, regjistrimin ose ndryshimin e kesaj Marreveshjeje, kompletimin apo ruajtjen e Barres Siguruese, zbatimin ne cdo forme te dispozitave ose ushtrimin e te drejtave, fuqive dhe mjeteve ligjore sipas Marreveshjes apo sipas Ligjit "Per barret siguruese".

4.4 DEKLARATAT DHE GARANCITË

Barredhenesi deklaron dhe garanton Bankën si më poshtë vijon:

- (a) Barredhenesi është pronar i vetem e legjitim i Pasurive dhe ka të drejta të plota dhe të ligjshme për të dhënë kolateralin;
- (b) Kolaterali është i lire nga cdo barre/peng;
- (c) nuk ka kërkesë padi apo pretendime në proces të ngritur përpara ndonjë gjykate apo paneli arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj, lidhur me kolateralin;
- (d) krijimi, dhënia dhe regjistrimi i kolateralit është në përputhje me objektin dhe qëllimin e aktivitetit të Barredhenesit dhe se të gjitha autorizimet e nevojshme apo të këshillueshme lidhur me ofrimin, vendosjen dhe regjistrimin e Barres Siguruese janë dhënë dhe janë të vlefshme;
- (e) krijimi, dhënia dhe regjistrimi i Barres Siguruese si dhe dispozitat e kësaj Marreveshjeje nuk shkelin asnjë marrëveshje apo deklaram tjetër për marrje përsipër detyrimi në të cilën Barredhenesi është palë apo ndonjë parashikim ligjor, rregullores, vendim apo urdhër tjetër të gjykatës apo të autoritetit publik apo të çdo dokumenti tjetër ligjor me fuqi detyruese për Shoqërinë dhe se të gjitha detyrimet e parashikuara nga kjo Marreveshje përbëjnë detyrime të vlefshme dhe të detyrueshme për zbatim nga Barredhenesi;

Të gjitha deklaratat dhe garancitë e Shoqërisë sipas kësaj dispozite zbatohen në mënyrë të përsëritshme nga Barredhenesi çdo ditë deri në përfundimin e kësaj Marreveshjeje.

Neni 5

ARKETIMI I BORXHEVE

Perpara ose pas Mospermbushjes, Barremarresit mund t'i jape njoftim mbi Barren Siguruese cdo personi qe eshte i detyruar te paguaje nje borxh apo detyrim qe perben Kolateral dhe mundet gjithashtu t'i drejtohet cdo personi per te bere te gjitha pagesat per llogari te nje borxhi te tille ndaj Barremarresit. Barredhenesi pranon qe cdo pagese e marre prej tij nga persona te tille ne rast Mospermbushjeje, qe eshte ne vazhdim, perpara apo pas njoftimit te ketij personi mbi Barren Siguruese, do te merret dhe mbahet nga ai per Barremarresin dhe do t'i jepet Barremarresit sipas kerkeses se tij. Ne rast Mospermbushjeje, Barredhenesi bie dakord te depozitoje te gjitha te ardhurat qe rezultojne ne llogarine e tij ne favor te Barremarresit ne banken e aprovuar nga Barremarresit.

Neni 6

RASTET E MOSPERMBUSHJES

Rastet kur njera nga ngjarjet e meposhtme ndodh apo kushtet qe vijojne perbejne mospermbushje, qe ketej e tutje do t'u referohemi si "Rast i Mospermbushjes":

- (a) deshtimi per te permbushur cdo lloj detyrimi, duke perfshire pa asnje kufizim mospagimin e principalit, interesave apo shuma te tjera qe perbejne pjese te Detyrimit te papaguar ne kohen e duhur sipas parashikimeve te Detyrimeve te Siguruara;
- (b) keqinterpretimi thelbësor nga ana e Barredhenesit ne cdo marreveshje ose transakcion ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit;
- (c) falimentimi ose mungesa e aftesise paguese te Barredhenesit, njoftimi kunder Barredhenesit i procedurave te falimentimit;
- (d) cdo proces gjyqësor qe behet i ekzekutueshem kunder Barredhenesit apo Kolateralit;
- (e) nese nje pale tjetër qe ka pretendim mbi barren siguruese kunder pasurise se Barredhenesit ben hapa per te ekzekutuar barre siguruese te saj;

- (f) nese Barredhenesi pushon apo paralajmeron se do te pushoje veprimtarine e vet tregtare, shet ose bie dakord te shese nje pjese te konsiderueshme te aseteve te veta pa zbatuar ligjin perkates ose pa e njoftuar Barremarresin;
- (g) nese, sipas Barremarresit, ne kushte te arsyeshme tregtare, Barra Siguruese ose Kolaterali vihet ne rrezik.

6.2 PERSHPEJTIMI

Ne rast Mospermbushjeje dhe ne cdo kohe me pas, Barremarresi nga ana e tij mund te deklaroje nje pjese ose te gjitha Detyrimet qe nuk konsiderohen te pagueshme me ane te kerkeses, te behen menjehere te tilla pa bere ndonje kerkese apo njoftim.

6.3 MJETET LIGJORE NE RAST MOSPERMBUSHJEJE

Ne rast Mospermbushjeje, plus te drejtave dhe mjeteve ligjore te tjera qe mund te kete sipas ligjit, Barremarresi mund:

- Te zgjedhe te mbaje te gjitha apo nje pjese te kolateralit ne permbushje te detyrimeve te Barredhenesit sipas kesaj marreveshjeje ne menyren e parashikuar ne ligjin "Per Barret siguruese"
- Te marre, te arketoje, te shese, te jape me qira, te marre para hua per te siguruara dorezimin e kolateralit tek palet e treta ose te veproje me kolateralin apo nje pjese te tij ne menyre te tille, sipas kushteve dhe termave te tilla, dhe ne kohen qe lejohet nga ligji "Per barret siguruese"; si dhe mund te kerkoje ne emer te tij dhe t'u paguaje te tjereve shuma te arsyeshme per shpenzimet e marra persiper dhe per sherbimet e kryera ne lidhje me marrjen, arketimin, kryerjen, marrjen e huase per sigurimin, shitjen e kolateralit ose fitimin e pagesave nga ai dhe mund t'ia shtoje sasine e ketyre shumave borxhit qe Barredhenesi ka ndaj Barremarresit.
- Te vazhdoje te ekzekutoje pagesat dhe te ushtroje te drejtat dhe mjetet ligjore te Barremarresit per te cilat parashikohet ne ligjin "Per barret siguruese" si dhe te gjitha te drejtat dhe mjetet ligjore ne dispozicion te barremarresit te cilat nuk bien ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar

6.4 MJETET LIGJORE JO-PERJASHTUESE

Te gjitha te drejtat, fuqite dhe mjetet ligjore te Barremarresit sipas kesaj marreveshjeje mund te ushtrohen ne vecanti ose te kombinuara dhe nuk zevendesojne, por jane shtese e cdo forme sigurimi ne vazhdim nga Barremarresi dhe te gjitha te drejtat e tjera, fuqite apo mjetet ligjore te Barremarresit, pavaresisht nga forma se si kane lindur apo jane krijuar.

6.5 PERGJEGJESIA PER MUNGESAT

Per sa kohe eshte ne perputhje me ligjin e zbatueshem, Barredhenesi mbetet pergjegjes per permbushjen e cdo Detyrimi qe nuk eshte permbushur plotesisht ose shlyer nga dhenia e te ardhurave qe lindin nga zbatimi i Barres Siguruese kundrejt Detyrimeve te Siguruara.

6.6. MBARIMI I BARRËS SIGURUESE

- Barra Siguruese e vendosur Kolateral sipas Nenit 2, ne cdo rast, mbetet ne fuqi deri ne permbushjen ne menyre te plote te gjithave detyrimeve qe rrjedhin nga Kontrate Kredie Bankare nr. 1687 rep, nr. 714 kol, date 03/04/2025. Ajo rregjistrohet me nje afat fillestar prej 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit te kesaj Marreveshje Siguruese prane Regjistrat te Barreve Siguruese me te drejte rinovimi te ketij regjistrimi nga ana e Bankes, deri ne permbushje te plote te detyrimeve te Kontrates se Kredise per te cilat eshte vendosur barra siguruese.
- Barra Siguruese do t'i lirohet Barrëdhënesit vetëm pas përmbushjes në mënyrë të plotë dhe të parevokueshme të të gjithave detyrimeve që rrjedhin nga Kontrate Kredie Bankare nr. 1687 rep, nr. 714 kol, date 03/04/2025, duke kryer njëkohësisht edhe ç'rregjistrimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese.

Neni 7

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

7.1 VAZHDIMESIA E SIGURISE

Kjo Marreveshje dhe Barra Siguruese e krijuar sipas saj nuk zevendesojne por konsiderohen si shtese e barreve te tjera siguruese te mbajtura nga Barremarresi, dhe konsiderohet nje Marreveshje ne vazhdimesi dhe Barre Siguruese deri kur perfundon me shkrim dhe nenshkruhet nga palet.

7.2 KOMUNIKIMI

Kur cdonjeres nga palet i kerkohet apo i jepet e drejta te njoftoje, te drejtoje ose t'i beje nje kerkese pales tjeter, ky njoftim, drejtim apo kerkese duhet te jete me shkrim dhe quhet i mjaftueshem kur dergohet me poste te thjeshte tek kjo pale, ne adresat e fundit te raportuara nga pala.

7.3 PASARDHESIT DHE CESIONARET

Kjo Marreveshje duhet te jete e detyrueshme per Barredhenesin dhe pasardhesit e tij ose saj dhe duhet te siguroje qe eshte ne favor Barremarresit, pasardhesve te tij dhe cesionareve. Kjo Marreveshje duhet te jete e cedueshme (transferueshme) nga Barremarresi qe eshte i lire nga pretendimet ndermjet Barredhenesit dhe Barremarresit, dhe Barredhenesi nuk ka te drejte t'i kundervihet cesionarit apo te ngreje ndaj tij pretendimet qe ai ka ndaj Barremarresit.

7.4 PRANIMI I SHOQERISE

Shoqeria pranon detyrimet e premtimet e Barredhenesit sipas kesaj Marreveshjeje dhe bie dakort te mos ndermarre asnje veprim qe mund te cenoje ose ndaloje zbatimin e tyre.

Neni 8

VERIFIKIMI DHE RAPORTIMI I TE DHENAVE

Palet ne kete kontrate deklarojne dhe garantojne me vullnetin e tyre te plotë dhe të lirë se informacioni i dhënë prej tyre , është i vërtetë, i saktë dhe i plotë dhe bien dakord dhe deklarojne si me poshte:

Duke kuptuar se, të dhënat e mia demografike dhe financiare të ruajtura në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë, do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar, si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Raiffeisen Bank sha dhe Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mia:

I jap pëlqimin tim të plotë, të lirë Raiffeisen Bank sha që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e aplikimit për të marrë kredi;
2. Vlerësimin e rrezikut të kredisë përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies time të kredisë me Raiffeisen Bank sha ;
3. Vlerësimin e besueshmërisë time si person i lidhur me kredimarrësit/bashkekredimarrësit.,

të njihet me detyrimet e mia ndaj institucioneve financiare kredidhënëse, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave të Regjistrin të Kredive, për të vlerësuar vlerën e ekspozimit kreditor në sistemin bankar e financiar, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer detyrimet financiare. Gjithashtu, jap pëlqimin tim që Raiffeisen Bank sha të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare, për kryerjen e raportimeve standarte dhe të detyrueshme në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.

Jemi informuar siç duhet për të drejtën tone për të kërkuar informacion mbi të dhënat tona gjatë periudhës së mbajtjes së tyre nga Raiffeisen Bank Sha , si dhe korrigjimin/rishikimin, në raste kur ato janë të pasakta, të paplota. Për një qëllim të tillë, unë jam i vetëdijshëm që çdo kërkesë për sa më sipër mund t'ia drejtoj Raiffeisen Bank si më poshtë:

- Në vëmendjen e Personit Përgjegjës i Raiffeisen Bank sha të cilit mund ti adresohen pretendimet mbi të dhënat e raportuara
- Adresa: Raiffeisen Bank, Rr. Tish Daija, Kompleksi KIKA 2, Tirane
- E-mail: rba.dataprotection@raiffeisen.al
- Telefoni: +355698022250
- Faqja e internetit: <https://www.raiffeisen.al/>

Kemi lexuar dhe kuptuar me kujdes përmbajtjen e kësaj klauzole të pëlqimit paraprak dhe njohim pasojat përkatëse ligjore në lidhje me përpunimin e të dhënave tona personale, informacionit financiar dhe/ose çdo informacioni tjetër në lidhje me veten time në cilësinë e Kredimarrësit/Dorezanesit/Bashkekredimarrësit dhe për këtë arsye unë e nënshkruaj këtë dokument me vullnetin tim të plotë dhe të lirë

Ky autorizim konsiderohet i dhene per te gjithë personat nenshkrues te kontrates , pra si per Kredimarrësit/Bashkekredimarrësit dhe te dhenat e tyre, ashtu dhe per Dorezanesit dhe /apo Garantoret.

9. TE NDRYSHME

- 9.1 Kjo marreveshje do te zbatohet dhe do te interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
- 9.2 Barredhenesi autorizon Barremarresin te rregjistroje formularet e njoftimit te rregjistrimit dhe dokumenta te tjere dhe te ndermarre te gjitha veprimet qe Barremarresi mund te mendoje se jane te nevojshme per te kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barres Siguruese, per te mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe per te ekzekutuar barren siguruese;
- 9.3 Kjo marreveshje eshte pjese e Kontrates se Kredise ne Llogarine Rrjedhese dhe e detyrueshme si per palet nenshkruese, ashtu dhe per personat qe mund te zene vendin e tyre ose te cileve u jane transferuar te drejtat apo detyrimet.
- 9.4 Palet mund te ndryshojne vetem me shkrim elementet e kesaj marreveshjeje dhe t'i pasqyrojne ato ne Regjistrin e Barreve Siguruese.

A2025000010008225444

- 9.5 Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.
- 9.6 Marreveshja nenshkruhet ne 5(pese) kopje origjinale nese eshte rasti ne prani te perkthyesit, nga te cilat nje kopje per Barredhenesin/Kredimarresin/Bashkekredimarresin, dy per Kredidhenesin/Barremarresin/Bashkekredimarresit, nje kopje per Qendren Kombetare te Biznesit dhe nje kopje depozitohet prane noterit.

BARREMARRES/ KREDIDHENESI

RAIFFEISEN BANK sh.a

Perfaqesuar nga:

Christian CANACARIS

Gledisa BUXHUKU

BARREDHENES

Shoqeria "GJONAJ GROUP HOLDINGS" shpk

Perfaqesuar nga

Kristjana ZHAMO

BASHKEKREDIMARRES

Shoqeria "INFO-Telecom" Shpk

Perfaqesuar nga

Ada OSMANAJ

